

V E N D I M

Nr.29, datë 21.1.1999

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SH.A. “ALBKROMI” DHE SH.A. “AMC” QË VEPROJNË NË SEKTORË ME RËNDËSI TË VEÇANTË STRATEGJIKË”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Privatizimin e shoqërive tregtare “ALBKROMI” Sh.a., dhe “AMC”, Sh.a.
2. Shoqëritë tregtare të mësipërme të fillojnë përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për privatizimin e shoqërisë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të përgatisë aktet ligjore dhe nënligjore të nevojshme për privatizimin e shoqërive tregtare të mësipërme dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko